



TI
THE
PO

Si ta filloj jetën
e re me Jezusin?



TI
THE
PO



Titulli në original:

You Said Yes

Përktheu: Irista Kaso

Editoi: Pëllumb Çollaku, Anxhela Nikolli

Përkthyer me leje nga:

OpenLife.church Network

Prodhuar nga Rrjeti i Kishëmbjelljes

“Jesus33”

Tiranë 2024

Detajet e librit?

Hyrja 5

Java 1: Fillimi i Ndjekjes Së Jezusit

Çfarë Do Të Thotë “T’i Thuash Po Jezusit”?6

Çfarë Ndodh Pasi I Thua Po Jezusit? 8

Kush Është Perëndia? 10

Si Na Udhëzon Perëndia?12

Çfarë Është Pagëzimi?14

Si Mund Ta Njoh Perëndinë?16

Çfarë Jam Duke Mësuar?18

Java 2: Të Jetoj Si Jezusi

Si Kush Po Bëhem? 20

Si Ta Lexoj Biblën?.....22

Si Të Lutem?24

Si Të Bëj Miq?26

Çfarë Është Adhurimi?.....28

Si Të Ndaloj Së Bëri Atë Që Është E Keqe Për Mua? 30

Përse Pushoi Jezusi?.....32

Java 3: Të Dua Si Jezusi

Si Të Dua Ashtu Siç Donte Jezusi?.....34

Mikpritja E Të Tjerëve36

Si Të Bëhesh Bujar?38

Dalloji Dhe Plotësoji Nevojat 40

Të Falim Të Tjerët.....42

T’u Tregojmë Të Tjerëve Për Jezusin44

Çfarë Ndodh Më Pas? 46

Hapat e Rradhës.....48





Hyrje

Sapo ke pranuar Jezusin, the Po. Çfarë vjen më pas?

Brenda këtij libri të shkurtër ke për të gjetur detaje në lidhje me vendimin që ti more për të ndjekur Jezusin.

Çdo ditë do të gjesh disa vargje nga Bibla, disa parime dhe ide që t'i praktikosh vetë.

Bashkë do t'ju përgjigjemi pyetjeve të tilla si “çfarë do të thotë kjo gjë”, “çfarë të bëj unë” dhe “çfarë ndryshimi sjell?” Shpresoj që ky libër i vogël do të jetë si një udhëzim për ty që sapo e ke filluar udhëtimin tënd me Jezusin.

Edhe pse libri është i organizuar në 21 ditë, ti lexo sa të duash vetë, ditë pas dite ose më shumë se aq. Mund ta mbarosh për 1 ditë, për disa ditë, për disa javë, si të duash ti. Mund t'i kthehesh edhe herë pas here. Nuk është qëllimi si të mbarosh librin, por të ndihmojë si udhëzues, të forcojë besimin dhe të fillosh t'u flasësh të tjerëve në lidhje me gjërat që po mëson.

Ndjekja e Jezusit është proces që tregohet hap pas hapi, ditë pas dite. Jemi shumë të gëzuar që po të ndihmojmë sadopak në këtë udhëtim fantastik që ke filluar.

Dita 01

Çfarë Do Të Thotë “T’i Thuash Po Jezusit”?

Sa gëzohemi që e pranove Jezusin dhe i the Po.

Njerëzit shprehen me fjalë të ndryshme për këtë moment, kur i thonë Po Jezusit. Disa thonë “ia përkushtova jetën Jezusit”, “pranova Jezusin”, “u bëra i krishterë”, “u shpëtova” ose “kam vendosur të ndjek Jezusin”.

Por çfarë do të thotë të ndjekësh Jezusin? Çfarë ndryshon tek ne dhe çfarë nuk ndryshon? Dhe pse?

Ky libër për këtë punë është, që t’iu përgjigjet pyetje të tilla.

Kështu që le ta fillojmë me pyetjen e parë: **Çfarë do të thotë “T’i Thuash Po Jezusit”?**

Të ndjekësh Jezusin do të thotë, të bëhesh si Ai. Por kush është Jezusi dhe përse duhet të bëhem unë si Ai?

Për ta gjetur përgjigjen e duhur le të shkojmë tek libri i parë i Biblës, Zanafilla. Aty thuhet që Perëndia në fillim krijoi botën me çdo gjë brenda, sigurisht edhe njeriun. Ai na dha një përgjegjësi, të shijojmë dhe kujdesemi për atë që Ai krijoi. Por njeriu bëri disa zgjedhje ku lëndoi veten, të tjerët, gjithë botën, madje edhe ne sot. Këto zgjedhje, që Bibla i quan mëkat, na ndanë nga një Perëndi i përsosur dhe u kufizua mundësia për të bërë atë punën që na dha Ai në fillim.

Shekuj më vonë, Perëndia dërgoi Birin e Tij në botë. Ai erdhi si

foshnje dhe quhej Jezus. Jezusi jetoi afërsisht 33 vite në tokë dhe i shpenzoi ato vite duke na treguar ne mënyrën më të mirë për të jetuar—që vjen duke dashur Perëndinë dhe duke dashur njëri-tjetrin. Dhe kështu Ai e mbylli hendekun që na mbante larg Perëndisë, Atit të Tij. E bëri duke vdekur në kryq dhe duke u ringjallur përsëri nga vdekja.

Por përse e bëri Jezusi këtë lloj sakrifice të madhe për ne, Ai që ishte plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri? Para se të vdiste Jezusi u ul me një burrë që quhej Nikodem një mbrëmje të vonë. Nikodemi kishte shumë pyetje në lidhje me “çfarë do të thotë të ndjekësh Jezusin”. Si përgjigje ndaj pyetjes së Nikodemit, kemi nga Jezusi disa nga vargjet më të famshme të Biblës.



“Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme. Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e vet në botë që ta dënojë botën, por që bota të shpëtohet prej tij.” Gjoni 3:16-17

Dashuria e Perëndisë për ty, për mua, për çdo njeri ishte aq e madhe, sa që Jezusi ishte i gatshëm për të vdekur për mëkatet tona me qëllim që ne të bëheshim pjesë e familjes së Tij përjetë. Është kjo lloj dashurie që duhet ta shtyjë çdo njeri t’i thotë *po* Jezusit, t’i thotë *po* dashurisë, faljes, dhe jetës së re që na jep Ai.

Nesër në ditën 2, do të shikojmë më në detaje sesi ndodh kjo gjë, por sot le të mendojmë për përgjigjen e Jezusit dhe le ta kthejmë atë në një lutje.

Lutu me fjalët e tua ose kështu:

Perëndi, unë kam vendosur të besoj që Jezusi është Biri Yt që Ti e dërgove për të më shpëtuar mua dhe gjithë botën. Unë nuk i kuptoj të gjitha, se çfarë do të thotë kjo gjë, por me aq sa di, unë dua ta ndjek Jezusin dhe të jetoj siç jetoi Ai. Faleminderit që më deshe aq shumë sa që dërgove Jezusin. Faleminderit që më ke ftuar dhe pranuar në familjen tënde. Amen.



Dita 02

Çfarë Ndodhi Pasi I Thashë Po Jezusit?

Ditën e parë e mbyllëm me lutje, ditën e dytë po e hapim me një lutje. Perëndia dëshiron të na dëgjojë kur lutemi.

Lutu me fjalët e tua ose kështu:



Perëndi, faleminderit për dhuratën e shpëtimit: që më shpëtove nga vetja, më bëre që të kem një miqësi të shëndetshme me Ty dhe më dhe një zemër të shëruar. Sot, këto ditë, çdo ditë, jepi formë jetës sime me anë të dashurisë Tënde. Unë besoj që Ti po më bën një krijesë të re. Në emrin Jezus lutem. Amen.

Kur lutesh mbylle me shprehjen, *në emrin Jezus* sepse kështu na tha vetë Jezusi: “kërkoni në emrin Tim”. **Kështu mund të lidhemi me Perëndinë, kur shkojmë para Tij dhe kërkojmë në emrin Jezus, i cili pagoi për mëkatet tona.** Dhe kjo lidhje e ngushtë me Perëndinë na duhet çdo ditë, sidomos tani që kemi vendosur të bëhemi më shumë si Jezusi.

Jezusi e jetoi jetën e Tij me integritet. I deshi armiqtë, e ngriti zërin për padrejtësitë dhe pranoi afër vetes njerëzit që kultura i largonte. **Pasi i themi Po Jezusit, fillon procesi që zgjat gjithë jetën; për t'u bërë si Ai, e ndjekim Jezusin ditë pas dite si modelin tonë.** Që i bie, me kalimin e kohës, ne ecim në gjurmën e Tij. Në fakt, kur Jezusi i përmblodhi të gjithë urdhërimet e Biblës, na kërkoi dy gjëra; ta duam Perëndinë me gjithçka kemi dhe ta duam të afërmin porsì veten tonë.

Por, a ndodh ky proces në mënyrë automatike apo kemi edhe ne një rol që kjo gjë të ndodhë? Në fakt, duhet përfshirja e të dyve, e Perëndisë dhe e zgjedhjes sonë.



Ai është shlyesi për mëkatet tona; dhe jo vetëm për tonat, por edhe për ato të të gjithë botës... Nga kjo e njohim se jemi në të. Ai që thotë se qëndron në të, duhet të ecë edhe vetë sikurse ka ecur ai. 1 e Gjonit 2:2, 5b-6

Të bëhesh si Jezusi është proces. Perëndia bën pjesën më të madhe, por ne bëhemi partnerë me Të në punën që po bën Ai. Në gjithë pjesën tjetër të librit do të shikojmë me nge tre mënyra sesi bëhet kjo gjë:

Së pari, mësojmë disa gjëra bazike sesi ndiqet Jezusi—

Kush është Perëndia? Çfarë do të thotë të bisedosh me Perëndinë dhe si ta njohësh Atë më shumë? Cilët janë hapat e duhur? Javën e parë, ditët në vazhdim këto gjëra do të theksojmë.

Së dyti, të jetojmë siç jetoj Jezusi—Kur Jezusi ishte në tokë, Ai na la shumë modele sesi të jetojmë aspekte të ndryshme të jetës, atë lloj jete që na afron më afër me Perëndinë, na ndihmon të lidhemi me Të dhe të jetojmë siç jetoj Ai. Këto janë disiplina shpirtërore ose praktika shpirtërore. Javën e dytë do të theksojmë këto gjëra më në detaje.

Së treti, të duam siç deshi Jezusi—kur duam të tjerët siç i deshi Jezusi kjo na rrit dhe na bën më shumë si Ai. Javën e tretë do të theksojmë këtë gjë, si mund ta praktikojmë dashurinë e Jezusit në jetën e përditshme.



Ndalo Për Pak Minuta Dhe Mendo:

Cilën pjesë të jetës sime po shpresoj që Perëndia do ta bëjë të re? Si mund të bashkëpunoj me Perëndinë për t'u kujdesur për të tjerët, ata njerëz që Ai ka vendosur në botën time, rreth e qark meje?

Dita 03

Kush Është Perëndia?

Ai është:

Perëndia Atë?

Perëndia Bir?

Perëndia Frymë e Shenjtë?

Apo të tre në një?

Po!

Kur zgjedh t'i besosh Jezusit dhe ta pranosh Atë në jetën tënde, ti ke marrë një vendim tre—në—një: Ftesa na vjen nga **Jezusi** (Biri i Perëndisë) për t'u bërë fëmijë i Perëndisë **Atë** dhe për t'u mbushur me **Frymën e Shenjtë** që të fuqizohesh për të jetuar si bir/bijë i Perëndisë. **Perëndia është tre në një.**

Në këtë mënyrë na shfaqet Perëndia dhe kështu e shikon në gjithë Biblën. Fryma e Perëndisë ishte e pranishme bashkë me Perëndinë Atë që nga fillimi, që nga Krijimi; ja si thuhet në vargjet e para të Biblës.



Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën. Toka ishte pa trajtë, e zbrazët dhe errësira mbulonte sipërfaqen e humnerës; dhe Fryma e Perëndisë fluturonte mbi sipërfaqen e ujërave.
Zanafilla 1:1-2

Më vonë, autori i ungjillit të Gjonit e shpjegon bukur fare historinë e Krijimit sepse përfshin edhe Jezusin në krijim, si Fjala e Perëndisë. Të ftoj të marrësh një Bibël ose të shkarkosh aplikacionin YouVersion nëse akoma nuk e ke, për ta lexuar të gjithë ungjillin e Gjonit. Nëse po lexon Biblën për herë të parë dhe do një sugjerim nga t'ia fillosh, filloje nga ungjilli i Gjonit dhe mbaroje gjithë Dhjatën e Re; pastaj filloje nga Zanafilla. Ja, i lexojmë bashkë disa vargje nga ungjilli sipas Gjonit më poshtë:



*“Në fillim ishte **Fjala** dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me **Perëndinë**. ... por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij... Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm laudinë e tij, si laudia e të vetëmlindurit prej **Atit**, plot hir e të vërtetë. Askush s’e pa Perëndinë kurrë; i vetëmlinduri **Bir**, që është në gjirin e Atit, ai e bëri të njohur. Ai, mbi të cilin do të shikosh se zbret Fryma dhe qëndron mbi të, është ai që pagëzon me **Frymën e Shenjtë**. Dhe unë pashë e dëshmova se ai është Biri i Perëndisë”.* Gjoni 1:1-2, 12, 14, 18, 33-34

Lexuam shumë vargje. Por dua ta mbyllim kështu ditën sot: Jezusi, Ati Perëndi dhe Fryma e Shenjtë janë Një. Jezusi nuk erdhi vetëm tëna tregojë se si është Perëndia, por erdhi edhe për të na hapur derën për tek Ati një herë e përgjithmonë me anë të Frymës së Shenjtë.



Lutu me fjalët e tua ose kështu:

Perëndi, më ndihmo të të njoh Ty në të tre dimensionet, si Atë, si Bir dhe si Frymë e Shenjtë. Atë, Ti je Ai që siguron për mua. Jezus, Bir, Ti je Shpëtimtari im. Frymë e Shenjtë Ti je udhëzuesi im. Në emrin Jezus lutem. Amen

Dita 04

Si Na Udhëzon Perëndia?

Dje u lutëm: “Zot, më ndihmo të të njoh Ty si Atë, Bir dhe Frymë të Shenjtë. **Frymë e Shenjtë, Ti je Udhërrëfyesi im.**”

Kush është Fryma e Shenjtë dhe si na udhëheq Ai? A duhet të veprojmë si shumë shpirtëror për të tërhequr vëmendjen e Frymës? Jezusi premtoi diçka ndryshe.

Jezusi e përshkroi Frymën e Shenjtë si ngushëllues, mbrojtës, ndihmës dhe mik. A njihni ndonjë të tillë? Ndoshta një që përkujdeset, nëna apo një mik i mençur? Ndërsa lexoni fjalët e Jezusit, mendoni për Frymën e Shenjtë si Ngushëlluesin, Mbrojtësin, Ndihmuesin dhe Mikun tuaj.



*“Dhe unë do t’i lutem Atit dhe ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju, **Frymën e së Vërtetës**, që bota nuk mund ta marrë, sepse nuk e sheh dhe nuk e njeh; **por ju e njihni, sepse qëndron me ju dhe do të jetë në ju.**”* Gjoni 14:16-17

Jezusi ua bëri këtë premtim ndjekësve të Tij ndërsa u tha atyre që së shpejti do të largohej për të qenë me Atin.



“Megjithatë unë ju them të vërtetën: është mirë për ju që unë të shkoj, sepse, po nuk shkova, nuk do të vijë te ju Ngushëlluesi; por, po shkova, unë do t’jua dërgoj.” Gjoni 16:7

Ndjekësit e Tij mund të jenë ndërë të hutuar, të shqetësuar apo edhe të braktisur, por Jezusi e sqaroi se largimi i Tij fizik ishte më shumë për t’u afruar me ta sesa për t’u larguar.



Nuk do t'ju lë bonjakë (jetimë), do të kthehem te ju. Edhe pak kohë dhe bota nuk do të më shohë më, por ju do të më shihni; sepse unë jetoj, edhe ju do të jetoni. Atë ditë do të mësoni se unë jam në Atin tim, dhe se ju jeni në mua dhe unë në ju.
Gjoni 14:18-20

Jezusi po jepte detaje sepse Fryma e Shenjtë do të jetë jo vetëm me ne, por në ne: Fryma bëri atë që Jezusi premtoi dhe erdhi për të mbushur ndjekësit e Tij me të njëjtin ngushëllim, të njëjtën fuqi dhe dashuri që mbushi Jezusin.

Kur i themi PO mënyrës të të jetuarit si Jezusi, ne e ftojmë Frymën e Shenjtë të na ndihmojë, ngushëllojë dhe të na mbrojë.



"Por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t'ju mësojë çdo gjë dhe do t'ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë." Gjoni 14:26

Zoti zgjedh të jetojë brenda nesh dhe të na udhëheqë. Në javët e ardhshme, do të identifikojmë hapa praktikë për t'u bërë më mikpritës ndaj pranisë së Perëndisë në jetën tonë.

Lutu me fjalët e tua ose kështu:



Perëndi, faleminderit për Frymën e Shenjtë. A do të vazhdosh të më ndihmosh të të njoh Ty si Ngushëllues, Ndhimës, Mbrojtës dhe Mik? Unë do të të besoj Ty që do të më drejtosh ndërsa ndjek rrugën e Jezusit. Në emrin e Jezusit, amen.

Dita 05

Çfarë Është Pagëzimi?

Në ditët e fundit, ne kemi mësuar për natyrën tre-në-një të Perëndisë – Atin, Birin dhe Frymën e Shenjtë – dhe sesi Perëndia jeton në ne me anë të Frymës së Shenjtë. Sot, do të lexojmë një histori tjetër nga Bibla me të tre personat e Trinitetit.

Tema kryesore që do të eksplorojmë sot është pagëzimi. **Pagëzimi është një mënyrë publike në të cilën ndjekësit e Jezusit deklarojnë vendimin e tyre për ta ndjekur Atë.** Një pastor ose mik i besuar qëndron në anën tënde kur je në det, liqen, lumë, pishinë; në një vend me ujë dhe të ndihmon të zhytesh nën ujë dhe të dalësh menjëherë nga uji.

Por pse të zhytesh? Është një simbol që paraqet vdekjen, ringjalljen dhe jetën e re përmes Tij

- Përkulja mbrapa duke u zhytur nën ujë simbolizon që mëkatet tuaja janë larë me vdekjen e Jezusit.
- Dalja nga uji është një pamje e rikthimit në një jetë të re, sikurse u ngrit Jezusi.

Kjo deklaratë publike e jetës sonë të re me Jezusin është e ngjashme me mënyrën sesi u pagëzua vetë Ai.



Atëherë erdhi Jezusi nga Galileja në Jordan te Gjoni për t'u pagëzuar prej tij. Por Gjoni e kundërshtoi fort duke i thënë: "Mua më duhet të pagëzohem prej teje dhe ti po ujen tek

unë?”. Dhe Jezusi, duke iu përgjigjur, u tha: “Lejo të bëhet për tani, sepse në këtë mënyrë përmbushim çdo drejtësi”. Atëherë ai e lejoi. Dhe Jezusi, sapo u pagëzua, doli nga uji; dhe ja, qiejt iu hapën, dhe ai pa Frymën e Perëndisë duke zbritur si një pëllumb e duke ardhur mbi të; dhe ja një zë nga qielli që tha: “Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur”. Mateu 3:13-17

Tani, rilexoni historinë dhe imagjinoni veten si person që po pagëzohesh nga Gjoni. Si është uji? Si ndihesh kur dëgjon miratimin e Perëndisë? Çfarë ju thotë konkretisht zëri i Perëndisë? Si e dallon praninë e Frymës së Shenjtë?

Në fund të kohës së Jezusit në Tokë, Ai mbledhi së bashku ndjekësit e Tij dhe ndau këtë mision:



*“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë.”
Mateu 28:19*

Kur i keni thënë Po mënyrës së jetesës si e Jezusit, pagëzimi është një nga hapat e mëtejshëm që jeni ftuar të ndërmerri. Mos harroni, është një deklaratë publike që i thotë botës: “Unë kam vendosur të ndjek Jezusin!”



Ndalo Për Pak Minuta Dhe Mendo:

A je pagëzuar? Si do të ishte për ty nëse e hedh këtë hap ndërsa po ndjek Jezusin? Çfarë pyetjesh keni akoma për pagëzimin?

Dita 06

Si Mund Ta Njoh Perëndinë?

Si fillon të njihesh me dikë? Shumica prej nesh fillojmë të njohim një mik të ri duke bërë pyetje, duke kaluar kohë së bashku dhe duke ndarë histori domethënëse nga jeta jonë.

Por ndërveprimi me Perëndinë mund të jetë pak më ndryshe sesa të dalësh për një kafe dhe të flasësh me miqtë e tu.

Pra, si ta njohim Perëndinë?

1. Ne kalojmë kohë me Perëndinë përmes lutjes.

Lutja është një mënyrë e shkëlqyer për të ndarë përvojat, bisedat, emocionet, nevojat dhe duke kaluar momente ndërtimi të besimit me Perëndinë.

Si të luteni? Lutja është komunikim me Perëndinë. Ju mund ta falënderoni Atë për atë që është, të kërkonit mbështetje ose thjesht të qëndroni në qetësi në praninë e Perëndisë. Lutja nuk është performancë, kështu që mos u shqetëso se mos thua gjëra “të gabuara”. Në vend të kësaj, është një mënyrë për t’u lidhur me Perëndinë, i cili të do. Kështu që ji i sinqertë. Nëse diçka është me rëndësi për ty, atëherë ndaje me Perëndinë.

Së fundi, Fryma e Perëndisë jeton në ty, prandaj kushtoj vëmendje mënyrave sesi Perëndia po përpiqet të të tërheqë vëmendjen ndërsa lutesh apo edhe gjatë gjithë ditës.

2. Ne lexojmë Biblën.

Bibla është një koleksion librash të shkruar nga njerëz mijëra vite më parë. Pra, pse duhet ta lexojmë ne sot atë?

Do të flasim më shumë për Biblën më vonë, por këtu janë disa baza. Bibla na ndihmon të kuptojmë sesi është Perëndia dhe si e kanë njohur Atë njerëz të tjerë si ne. Autorët, të udhëhequr nga Fryma e Shenjtë, tregojnë histori të mirësisë së Perëndisë, bëjnë pyetje që lidhen me jetën dhe merren me pjesët më të vështira të jetës.

Gjatë gjithë Biblës, ne arrijmë të shohim cilësitë e Perëndisë, si mirësia, falja dhe drejtësia e Tij. Dhe mund t'i shohim ato cilësi të jetuara nga jeta e Jezusit.

3. Mblidhemi bashkë me ndjekësit e Jezusit.

Të njohësh Perëndinë ka lidhje me të dyja “Jezusi dhe unë” dhe “Jezusin dhe ne”. Bibla na kujton praktikisht sesi ta ndjekim Jezusin dhe ta njohim Perëndinë së bashku.



Dhe le të kujdesemi për njëri-tjetrin, për t'u nxitur për dashuri dhe vepra të mira, pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë...
Hebrenjve 10:24-25

Ne e njohim më mirë Atë duke dëgjuar histori për besnikërinë e Perëndisë, duke dëgjuar urtësi nga Bibla dhe duke kënduar këngë për dashurinë e Perëndisë.

Një mënyrë shumë e lehtë për ta krijuar zakonet e të mbledhurit me ndjekësit e Jezusit është të shkosh rregullisht në kishë. Është një mundësi për të bërë miq, për të ndarë sesi po vepron Perëndia në jetën tënde dhe për të mësuar sesi të shërbehesh dhe inkurajosh të tjerët.

Nëse ende nuk e ke krijuar këtë zakon, bëje plan që të mblidhesh me të tjerët në kishë që këtë javë. Madje fto dhe një mik, anëtar të familjes ose një komshi, në mënyrë që edhe ata të mund ta përjetojnë eksperiencën jetë-ndryshuese të Jezusit.

Dita 07

Çfarë Jam Duke Mësuar?

Urime! Arrite deri në fund të javës së parë. Jemi shumë krenarë për ty që ke hedhur hapa të qëllimshëm për ta rritur besimin tënd.

Të vendosësh që do të ndjekësh Jezusin është një vendim i madh dhe ndoshta këto që ke lexuar të kanë trazuar, ose ke marrë ide të reja ose të janë ngritur pyetje, apo ndoshta edhe dyshime të reja. S'ka problem. Mbaj mend, **të ndjekësh Jezusin është një udhëtim jete, kështu që nuk është nevoja që t'i zbulojmë të gjitha misteret e besimit brenda një jave.**

Meqë ra fjala tek jeta - Si po ia kalon?

Më poshtë, ka një hapësirë ku të shkruash dy, tre fjali për të përshkruar sesi ndihesh për udhëtimin e besimit tënd. Ndoshta ndihesh i/e emocionuar dhe me pritje ose mund të ndihesh pak i/e pasigurt. Ndoshta edhe s'ke fjalë akoma për ta përshkruar saktësisht sesi ndihesh.

Mos u shqetëso për të shkruar një përgjigje "të saktë". Përgjigja e sinqertë është në fakt përgjigja më e saktë.

Nuk është e nevojshme t'i ndash këto fjali me të tjerë por është thjesht një moment për të reflektuar.

1. _____
2. _____
3. _____

Në javën e kaluar, pamë se Perëndia na do, na fal dhe na jep një qëllim, të bëhemi çdo ditë e më shumë si Jezusi. Ne kemi parë gjithashtu se Ai dëshiron të ketë një marrëdhënie të ngushtë me ne, kështu që Ai na ka ofruar mënyra dhe mundësi për t'u lidhur dhe miqësuar me Të.

Ne sapo kemi hedhur hapat e parë në njohjen dhe ndjekjen e Jezusit dhe jemi shumë të gëzuar për të vazhduar këtë udhëtim së bashku.

Ndërsa mbyllim javën e parë dhe bëhemi gati për javën e dytë, mendoni dhe shkruani një ose dy pyetje që mund të keni për Perëndinë, besimin ose Biblën. Pastaj, **ndaji ato me një pastor, drejtues ose mik të besuar gjatë kësaj jave.**

Lexo vargun më poshtë dhe mendo për një ose dy minuta përpara se të flasësh me Perëndinë për atë që ke shkruar më lart.



... ai që nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën e Jezu Krishtit. Filipianëve 1:6

Dita



Si Kush Po Bëhem?

Mirë se erdhe në javën e dytë të udhëtimit tonë tre-javor (ose javën e katërt, të pestë apo sado gjatë që po të shkon)! Javën e kaluar, zbuluam se të jesh i krishterë fillon me zgjedhjen për të pranuar dhuratën e faljes së Perëndisë, e ndjekur nga një proces i përgjeshëm për t'u bërë më shumë si Jezusi.

Tani, mund të pyesësh veten: Si ngjan në të vërtetë të bëhesh më shumë si Jezusi?

Ore, a është e mundur të bëhesh më shumë si Jezusi?

Në fund të fundit, Jezusi është Perëndi, Krijuesi i gjithçkaje, që ka ekzistuar gjithmonë dhe që kurrë nuk mëkatoi. Si mund të bëhemi ne si Ai?

Po mirë, si bëhet dikush një violinist koncerti, sportist profesionist ose ekspert kuzhine? Së pari, **e fillon diku**. Ti i the PO një mënyre të re jetese. Të thuash Po nuk të bën mjeshtër, por të bën nxënës në procesin për t'u bërë diçka më shumë.

Si nxënës, ti fiton njohuri, zhvillon marrëdhënie, praktikon aftësi dhe kapërcen pengesa. Nxënësit gjithashtu bëjnë gabime, dështojnë dhe vazhdojnë të ecin përpara. Fjala që Jezusi përdori për një nxënës është “dishepull”.

Kur i the Po Jezusit, i thamë Po një procesi të gjatë sa jeta për t'u bërë dishepull i Tij.

Për dy javët e ardhshme, do të shikojmë sesi të jesh dishepull i Jezusit. **Së pari, do të mësojmë për disa zakone dhe mendësi që Jezusi i vlerësoi dhe i jetoi, të ashtuquajtura praktika shpirtërore.** Më pas, do të eksplorojmë sesi na deshë Jezusi dhe si mund të tregojmë ne të njëtin lloj të kujdesit sakrifikues ndaj të tjerëve.

Gjatë kohës së Jezusit në Tokë, disa njerëz po përpiqeshin të kuptonin nëse Jezusi ishte vërtet Biri i Perëndisë. Ata e pyetën: “Cili është urdhërimi më i madh i Perëndisë?” Ai u përgjigj:



...Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd e me gjithë mendjen tënde. Ky është urdhërimi më i madh dhe i pari. Dhe urdhërimi i dytë, i ngjashëm me këtë, është: duaje të afërtin si veten. Nga këto dy urdhërime varen tërë ligji dhe profetët.’ Mateu 22:37-40

Jezusi e përmbodhi të gjithë fjalën e Perëndisë në: Duaje Perëndinë dhe duaje të afërmin tënd si veten. Të bëhesh ky lloj personi, që e do Perëndinë dhe e do të afërmin, është një proces që të merr kohë sa gjithë jeta.

Çdo dishepull përjeton pengesa, vështirësi, sfida. Nëse je si të gjithë njerëzit, ka gjasa që i ke përjetuar tashmë disa nga ato pengesa. Mund t’i jesh rikthyer një zakoni të keq, apo ke përdorur fjalë lënduese ndaj dikujt ose ke gabuar javën e kaluar. Kur gabon, s’ke nevojë të fshihesh apo të ikësh larg Perëndisë apo nga të tjerët. Ai është i mirë dhe gjithmonë fal, kjo është e disponueshme për t’na ndihmuar në udhëtimin tonë për t’u bërë më shumë si Jezusi.

Lutu me fjalët e tua ose kështu:



Perëndi, ti i sheh gabimet që bëj. Faleminderit që më fal dhe më udhëzon ndërsa unë po bëhem më shumë si Jezusi. Frymë e Shenjtë, a do të më ndihmosh të shoh një hap që mund të hedh për t’u rritur në dashurinë ndaj Ty, veten dhe të tjerët sot? Në emër të Jezusit, Amen

Dita



Si Ta Lexoj Biblën?

Për Jezusin, Bibla ishte shumë më tepër sesa e zeza në të bardhë. Kjo për shkak se Perëndia i dha formë Biblës për t'u treguar ndjekësve të Jezusit brez pas brezi sesi të jetojnë dhe të duan. Por si ta përdorim atë? Në fund të fundit, është një libër i madh dhe i vjetër plot me poezi, këngë, histori, ligje dhe letra antike.

Bibla ka dy seksione kryesore. E para quhet Bibla Hebraike ose Dhjata e Vjetër. E dyta është Dhjata e Re. Dhjata e Re u shkrua pas jetës së Jezusit. Por, edhe pse Jezusi lexoi vetëm nga Dhjata e Vjetër, mënyra sesi Ai e përdori Dhjatën e Vjetër na tregon sesi ta lexojmë të gjithë Biblën.

Le të fillojmë duke parë dy mënyra sesi Jezusi e përdori Biblën.

1. Jezusi përdori Biblën për të treguar dashurinë e Perëndisë për njerëzit.

Tek Mateu 22, një person e pyet Jezusin: “Cili është urdhërimi më i madh nga Perëndia?” Ju ngjan e dëgjuar? E lexuam këtë pasazh dje, por le ta rilexojmë dhe të shohim sesi mund të na ndihmojë ta lexojmë më mirë Biblën.



... 'Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd e me gjithë mendjen tënde. Ky është urdhërimi më i madh dhe i pari. Dhe urdhërimi i dytë, i ngjashëm me këtë, është: duaje të afërtin si veten. Nga këto dy urdhërime varen tërë ligji dhe profetët.' Mateu 22:37-40

Jezusi citoi Biblën për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë zemrën e Perëndisë dhe mënyrën sesi Ai na thërret ne të jetojmë. Pra, ndërsa lexojmë Biblën, mund të jetë e dobishme të bëjmë pyetjen: “Si më ndihmojnë këto fjalë ta dua Perëndinë dhe t'i dua të tjerët?”

2. Jezusi e përdori Biblën në kontekst.

Tek Mateu 4, Jezusi tundohet nga një armik shpirtëror.

Armiku citon Biblën për t'i bërë gënjeshtat e tij të duken si mënyra shpirtërore – por Jezusi nuk mashtrohet. Kjo sepse Ai e kupton vlerën e kontekstit.

Autorët e lashtë e shkruan Biblën në gjuhë dhe këndvështrime të ndryshme nga ato që kemi sot. Kur lexojmë Biblën, është e rëndësishme të bëjmë shumë pyetje si: “Kush e shkroi këtë? Kujt po i shkruan? Çfarë zhanri është ky libër (poezi, histori, letër, etj.)? Dhe, çfarë po ndodh në këtë libër apo kapitull?”

Kur nuk e lexojmë në kontekstin e duhur, rrezikojmë të humbasim thelbin që Bibla po përpiqet të na japë. Edhe më e keqja, mund të arrijmë në një përfundim që është e kundërta e mënyrës së jetesës që Perëndia ka për ne. Kur ke dyshime, pyet veten: Si më ndihmojnë këto fjalë nga Bibla ta dua Perëndinë dhe ta dua të afërmin?

Bibla është më shumë sesa thjesht e zeza në të bardhë. Është një dhuratë nga Zoti që ka fuqinë të na transformojë nga brenda jashtë.

Kjo është arsyeja pse mund të jetë e dobishme të mendosh për këtë praktikë si *studim* ose *mësim* të Biblës në vend që thjesht ta *lexosh* atë. Bibla është krijuar për t'u lexuar, rilexuar, eksploruar, medituar dhe reflektuar mbi të – herë pas here dhe pa pushim.

Dita 10

Si Të Lutem?

Jezusi kaloi shumë kohë në lutje. Bibla na thotë në shumë raste që Jezusi qëndroi zgjuar gjithë natën për t'u lutur. Pse? Ai është Perëndia apo jo? Pse ka nevojë të lutet Ai?

Gjatë kohës së Jezusit në Tokë, Ai ishte plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri. Si njeri, Ai ishte si ne dhe kishte nevojë të përdorte zakone të vazhdueshme për ta mbajtur marrëdhënien e Tij me Perëndinë, Atin e Tij. Për Jezusin, lutja ishte një burim drejtimi, guximi dhe lidhje me Perëndinë dhe lutja mund të bëjë të njëjtën gjë për ne.

Shikoni sesi Jezusi u përgatit për të bërë një zgjedhje të madhe, duke zgjedhur një grup, skuadër kyçe që do të ishin personat që do të themelonin kishën.



Gjatë atyre ditëve Jezusi shkoi në mal për t'u lutur dhe e gdhii duke iu lutur Perëndisë. Kur u bë ditë, i thirri dishepujt pranë vetes, zgjodhi dymbëdhjetë prej tyre dhe i quajti apostuj.... Luka 6:12-13

Jezusi nuk u lut vetëm kur ishte përpara vendimeve të mëdha. Por, u lut gjithashtu që të përjetonte afërsinë me Perëndinë dhe të gjente forcë përpara se të përballej me situata të vështira. Si mund të zhvillojmë ne një zakon lutje, si e Jezusit?

Së pari, le të flasim sesi Jezusi nuk u lut.

- Jezusi nuk i mbushi lutjet e Tij me fjalë të mëdha dhe të zbkuruara.
- Jezusi nuk u lut për t'i rënë në sy njerëzve përreth Tij.

- Jezusi nuk u lut me një listë kërkesash ndaj Perëndisë.

Lutja ka për qëllim të jetë një bisedë personale me Perëndinë – siç do ta kishe me miqtë, familjen ose një shok/shoqe. Hiqe merakun, presionin. Hiq dorë nga mënyra sesi mendon se duhet të lutesh dhe thjesht fol me Perëndinë hapur dhe sinqerisht.

Pra, si u lut Jezusi?

- Jezusi e bëri lutjen një prioritet.
- Jezusi u lut në prani të të tjerëve dhe Jezusi u lut vetëm.
- Jezusi u kërkoi të tjerëve të luteshin për Të.



Kështu që sot, le të fillojmë zakonin e lutjes. Thjesht kalo disa minuta duke folur me Perëndinë ndërsa je duke u kthyer nga puna për në shtëpi ose përpara se të shkosh për të fjetur. Tregoji Atij për çfarë je mirënjohës, kërkoi prej Tij atë që të nevojitet dhe dëgjoje zërin e Tij. Ndërsa e bën këtë, ke për ta forcuar çdo ditë marrëdhënien tënde me Jezusin.

Dita 11

Si Të Bëj Miq?

Gjatë gjithë shërbesës së Tij, Jezusi e rrethoi veten me njerëz që mund ta inkurajonin Atë, të luteshin për Të dhe ta mbështesnin Atë. Po, Jezusi ishte Shpëtimtari i tyre, por Ai ishte edhe miku i tyre.

Ja sesi foli Jezusi për marrëdhënien me ndjekësit e Tij:



“Nuk ju quaj më shërbëtorë, se shërbëtori nuk e di ç'bën i zoti. Por unë ju kam quajtur miq, sepse ju bëra të njohur gjithçka që dëgjova prej Atit tim.” Gjoni 15:15

Nëse Jezusi pati marrëdhënie të ngushta, është gjë e mirë që edhe ne të krijojmë marrëdhënie të ngushta me ndjekësit e tjerë të Jezusit.

Ndonjëherë jeta mund të duket jashtëzakonisht e vështirë dhe në ato momente, ne kemi nevojë për njerëz tek të cilët mund të mbështetemi për lutje, udhëzime dhe mbështetje. Në kohë gëzimi, kur feston me miq ato momente mund të bëhen edhe më domethënëse.

Këto gjëra janë të vërteta në lidhje me marrëdhëniet sepse Perëndia na bëri të jemi si Ai. Perëndia është në marrëdhënie jetëdhënëse me Vetën si At, Bir dhe Frymë e Shenjtë dhe Ai dëshiron të ketë një marrëdhënie me ne. Kjo është arsyeja pse të rrethosh veten me njerëz që ndjekin Jezusin është praktikë shpirtërore shumë jetike. Sepse kur je duke bërë këtë gjë, je duke ndjekur shembullin e Perëndisë.

A ke marrëdhënie të ngushta me njerëzit? Me njerëz që të inkurajojnë në marrëdhënien tënde me Jezusin dhe të mbështesin në ditë të mira dhe ditë të këqija? Nëse jo, mendo sesi mund të investosh në marrëdhëniet që ke tashmë ose të gjesh miqësitë që të nevojiten.

Nëse aktualisht nuk ke miq të afërt, që e ndjekin Jezusin, gjetja e një grupi të vogël ndjekësish të tjerë të Jezusit është një vend i duhur për të filluar.

Gjetja dhe krijimi i miqësive të ngushta mund të jetë e sikletshme ose e çuditshme por ia vlen. Miqësitë e mira janë jetëdhënëse, kur gjen dhe ke miq që festojnë me ty, të mbështesin dhe të inkurajojnë të vazhdosh ta njohësh Jezusin dhe të bëhesh si Ai çdo ditë.

Dita 12

Çfarë Është Adhurimi?

A e di se çfarë ndodh kur bashkohen një grup ndjekësish të Jezusit, mësojnë Shkrimin, i luten Perëndisë dhe ndërtojnë marrëdhënie që janë jetë-ndryshuese? Po adhurojnë.

Jeta e Jezusit karakterizohet nga adhurimi. Cilat fjalë ju vijnë në mendje kur mendoni për adhurimin? Ndoshta fjalë si muzika, instrumentat, këngët - gjë që është e vërtetë! Këndimi është sigurisht një mënyrë me të cilën Jezusi adhuroi.

Në mbrëmjen para kryqëzimit Jezusi hëngri një darkë me miqtë e Tij. Ishte Pashka, një festë e rëndësishme për popullin hebre.

Në fund të darkës, Jezusi dhe dishepujt kënduan së bashku. Në kulturën e lashtë hebraike, njerëzit shpesh këndonin Psalmet 113-118 për të festuar Pashkën. Ka të ngjarë që Jezusi të ketë kënduar këto fjalë lavdërimi:



Kush i përngjan Zotit, Perëndisë tonë, që banon në vende shumë të larta, kush ulet për të parë gjërat që ndodhen në qiejt dhe mbi tokë? Ai e ngre të mjerin nga pluhuri dhe nevojtarin nga plehrat, për ta bërë të ulet me princat, me princat e popullit të tij. Psalmi 113:5-8



Atëherë i kërkova ndihmë Zotit: "O Zot, të lutem, më shpëto". Zoti është i dhembshur dhe i drejtë, Perëndia ynë është i mëshirshëm. Zoti mbron njerëzit e thjeshtë; unë isha katandisur në një gjendje të mjeruar, dhe ai më shpëtoi. Kthehu, o shpirti im, në prehjen tënde, sepse Zoti të mbushi me të mira. Psalmi 116:4-7

Këto fjalë lavdërimi shprehin nderim dhe ngrenë lart cilësitë dhe karakterin e Perëndisë. Ai është Krijuesi dhe Sunduesi i botës. Ai nuk ka nevojë të kujdeset për ne, por Ai kujdeset sepse na do. Ai u kushton vëmendje të veçantë njerëzve që kanë nevojë për mbështetje fizike ose shpirtërore.

Sot, ashtu si festimi i Pashkës, shërbesat—festimet e adhurimit bëhen për t'iu dhënë mundësinë njerëzve të adhurojnë Perëndinë së bashku si grup, si familje. Këngët e adhurimit u kujtojnë ndjekësve të Jezusit se kush është Perëndia dhe çfarë ka bërë Ai, dhe t'i japin Atij lavdërimin që e meriton.

Të kënduarit është një mënyrë sesi mund ta adhurojmë Zotin, por adhurimi shkon përtej muzikës.

Ne adhurojmë sa herë që shprehim përkushtimin tonë ndaj Zotit. Kur adhurojmë Perëndinë, ne po shpallim cilësitë e Tij të mrekullueshme dhe gjërat që ka bërë Ai.

P.sh. kur shikon një perëndim dielli, lindjen e një fëmije ose përjeton një përgjigje lutje mund të krijosh gjithashtu momente lavdërimi. **Çdo moment që na kujton cilësitë dhe karakterin e Perëndisë është mundësi adhurimi.**

Këtë fundjavë, do të kesh mundësi të adhurosh Perëndinë duke kënduar me ndjekësit e tjerë të Jezusit në kishë. Por, mos prit deri të dielën për të adhuruar Perëndinë.

Kalo disa minuta tani për të kujtuar se për çfarë je mirënjohës. Ndoshta është bukuria e krijimit të Perëndisë, një shoqëri e re apo “e vjetër” ose falja e Perëndisë nëpërmjet Jezusit. Shprehni mirënjohjen tuaj Perëndisë për atë që Ai është dhe për atë që Ai ka bërë.

Dita 13

Si Të Ndaloj Së Bëri Atë Që Është E Keqe Për Mua?

A ke ndonjëherë dëshirë të bësh diçka edhe pse e di që është e gabuar?

Për tre vjet, gjithçka në jetën e Jezusit ishte e parehatshme. Ai ndau të vërteta të parehatshme me njerëz në pushtet, duroi sulmet e përditshme nga kritikët e Tij dhe dëgjonte vazhdimisht komplete për ta vvarë Atë. Por në fillim të historisë së Tij, Ai mori një ofertë për t'i kapërcyer të gjitha vuajtjet dhe për të marrë një rrugë më të lehtë.

Për 40 ditë, Jezusi ndenji vetëm në shkretëtirë pa ushqim. Ndërsa ishte i brishtë, djalli i ofroi Atij një mënyrë të lehtë për t'i shpëtuar vuajtjes. (Kjo histori është me detaje tek Mateu kapitulli 4:1-11.)

Ne tundohemi kur na ofrohet një rrugë e shkurtër për diçka që duam. Të ndihesh i tunduar nuk është mëkat. Por dorëzimi ndaj tundimit mund të komprometojë integritetin tonë dhe të na çojë në një cikël të dhimbshëm zgjedhjesh të këqija. Si ta kapërcejmë tundimin? Duke i mbajtur sytë te Jezusi.

Praktikat shpirtërore të Jezusit e ndihmuan që ta kapërcente tundimin.

Jezusi e njihnte Biblën dhe Ai gjithashtu e dinte qëllimin e Tij dhe mënyra sesi do e jetonte, do të përfshinte marrjen e vendimeve

të vështira dhe të parehatshme për të mirën e të tjerëve. Vetëm duke bërë ato zgjedhje Ai mundi ta ndryshonte botën. Duke mos zgjedhur rrugën më të lehtë dhe asnjë rrugë të shkurtër.

Me fjalë të tjera, Jezusi e dinte se kush ishte dhe i kujt ishte. Pra, Ai refuzoi të kompromentote identitetin e Tij dhe thirrjen për kënaqësi ose lehtësim të momentit.

Ne përballemi çdo ditë me tundime, të mëdha dhe të vogla, që mund të na shpërqendrojnë nga ajo që po bëhemi. Ja lajmi i mirë: Perëndia dëshiron të ndihmojë që ta kapërcesh tundimin.

Lexoni se çfarë tha një ndjekës i Jezusit për tundimin.



Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t`ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t`ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni. 1 e Korintasve 10:13

Le të jemi si Jezusi dhe të përgatitemi për tundimin përpara se të na godasë. Ne e bëjmë këtë gjë duke studiuar, besuar dhe jetuar të vërtetat e Perëndisë në Bibël, duke i kërkuar ndihmë Perëndisë nëpërmjet lutjes, duke e ndarë në mënyrë të sigurtë me të tjerët dhe duke kërkuar mundësitë që na jep Perëndia për t'i shpëtuar tundimit.

Ndonjëherë mundësia që ofron Perëndia mund të ngajjë e tillë: bëhesh pjesë një grupi të vogël, bisedon me një profesionist të fushës ku po has sfidën ose të takohesh me një pastor për të gjetur mjetet që të nevojiten për të fituar lirinë.

Lutu me fjalët e tua ose kështu:



Perëndi i dashur, faleminderit që më jep gjithmonë një mundësi tjetër. Më ndihmo ta njoh dhe t'i rezistoj tundimit kur të vijë. Në emër të Jezusit, Amen.

Dita 14

Përse Pushoi Jezusi?

A ndjen ndonjëherë ankth për gjërat që ndodhin gjatë javës? Apo, do të doje të kishe më shumë kohë për njerëzit? Nëse po, nuk je vetëm. Jeta shpesh duket se na kërkon të jemi të zënë. Por Jezusi na fton për një mënyrë jetese të ndryshme (dhe më të mirë).

Shikoje këtë pasazh befasues nga jeta e Jezusit:



Megjithatë, fjala për Jezusin përhapej gjithnjë e më shumë dhe turma të mëdha mblidheshin për ta dëgjuar e për t'u shëruar nga sëmundjet e tyre. Por ai u tërhoq në vende të shkreta e lutej. Luka 5:15-16

Shiko se çfarë thotë ky pasazh. Njerëzit donin ta dëgjonin Jezusin kur fliste dhe të merrnin shërim, megjithatë Jezusi zgjodhi të largohej që të mund të pushonte. Kur Ai sakrifiko produktivitetin dhe mundësitë për të ndihmuar të tjerët në mënyrë që të pushonte, kjo ishte gjë e mirë. Pse?

Ne mund të jemi të dobishëm kur jemi të shëndetshëm.

Pra, si Jezusi, ne mund të vendosim kufij me kohën tonë dhe ta ngadalësojmë me qëllim ritmin. Të gjithë njerëzit kanë nevojë për pushim dhe çlodhje dhe për shkakun se Jezusi ishte plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri, ndërsa ishte në Tokë, ai kufizim ishte i vërtetë edhe për Të.

Edhe pushimi është adhurim. Bibla fillon me krijimin e botës nga Perëndia. Historia e krijimit tregohet me një strukturë shtatë ditore për të përshkruar punën e Perëndisë. Në ditën e gjashtë Zoti krijoi njerëzit, por dita e shtatë ishte ditë pushimi. Pse është e rëndësishme kjo? Sepse shiko, dita e parë e njeriut në tokë ishte një ditë pushimi - jo ditë pune.

Në të gjithë Biblën, dita e shtatë e javës quhet e Shabat. Në atë ditë, njerëzit ftohen të adhurojnë duke mos bërë punë. Por si bëhet ky adhurim?

Është e lehtë të harrosh këtë të vërtetë shpirtërore dhe themelore: *Nuk jemi në kontroll, Perëndia është në kontroll.* Kur e harrojmë, priremi të bëjmë përpjekje për ta kontrolluar jetën tonë përmes punës. Fillojmë të fiksohemi me gjërat që duhen bërë dhe shqetësohemi se mos ngelim prapa.

Kur zgjedhim të bëjmë një pushim, ne po themi se, punët e pa mbaruara, rrobat që s'janë palosur dhe emailt e pa lexuara nuk e prishin planin e Perëndisë për botën. Kjo është arsyeja pse e shtuna, një kohë e kushtuar pushimit, është adhurim.

Ndoshta ti e ke punën e tillë që duhet të punosh me orë të gjata dhe ke njerëz që varen nga ti. Mos u ndje në faj nëse s'je në gjendje të marrësh një ditë të plotë pushimi çdo javë, për të pushuar. Në vend të kësaj, gjej momente për të pushuar kur ta kesh mundësinë. Jezusi bëri të njëjtën gjë. Një herë, kur ishte i lodhur, Ai thjesht u ul pranë një pusi. Një herë tjetër, Ai mori një sy gjumë në një varkë.

Po ti? Si mund ta bësh një ditë pushim çdo javë dhe si mund të krijosh momente pushimi në çdo ditë?

Dita 15

Si Të Dua Ashtu Siç Donte Jezusi?

Mirësevini në javën e fundit të udhëtimit tonë!

Javën e kaluar, filluam disa praktika shpirtërore për të na ndihmuar të jetojmë siç jetoi Jezusi. Dëshmuam sesi mendësitë, praktikat dhe zakonet e Tij i hapën rrugën shërbesës së Tij. Këtë javë, ne do të shikojmë sesi donte Jezusi. Me fjalë të tjera, si lidhej Jezusi me njerëzit e tjerë? Si i bëri të ndihen njerëzit? Dhe si i përdori fjalët dhe veprimet për të përmbushur qëllimin e Tij?

Le të shohim një argument që Jezusi zgjodhi ta ndalonte. Ndodhi midis disa miqve dhe ndjekësve të Tij:



*Mes dishepujve lindi pyetja se kush prej tyre ishte më i madhi. Por Jezusi, që i njihnte mendimet e zemrës së tyre, mori një fëmijë dhe e mbajti pranë. Atëherë u tha dishepujve: “Kush e pranon këtë fëmijë në emrin tim, më pranon mua e kush më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar. **Më i vogli ndër të gjithë ju, ai është më i madhi.**” Luka 9:46-48*

Dishepujt kishin idenë e gabuar sesi të arrinin madhësitinë si ndjekës të Jezusit. Ndoshta ata mendonin se më i madhi ishte ai që bënte mrekullitë më të mëdha ose e njihnte më mirë Biblën. Por Jezusi ka një përkufizim të ndryshëm të madhësisë.

Jezusi tha se personi që pranon një fëmijë është më i madhi. Çfarë? Pse kjo e bën dikë të madh?

Jezusi e shpjegoi: “Ai që është më i vogli prej jush është më i madhi.”

Me fjalë të tjera, Jezusi tha se më i madhi në sytë e Perëndisë është personi që nuk kërkon prestigj, fuqi apo një platformë. Në vend të kësaj, ata që kërkojnë të shërbejnë me përulësi.

Jezusi, i cili është Perëndi, erdhi si foshnjë në një familje të përlulur në një fshat të vogël. Kur u rrit, Ai nuk i urdhëroi ndjekësit e Tij si shërbëtorë. Në vend të kësaj, Ai i udhëhoqi me durim dhe kërkoi mënyra sesi t'i përmbushte nevojat e tyre.

Kjo është arsyeja pse Ai na thotë se mënyra për të qenë më i madhi në mbretëri është të bëjmë vazhdimisht mirë pa kërkuar vëmendje apo lëvdata. Këto janë hapsirat se ku mund të shërbejmë. Dhe ky lloj qëndrimi na ndihmon ta shohim njëri-tjetrin ashtu siç na sheh Perëndia, të gjithë të barabartë, të krijuar sipas shëmbëlltyrës së Tij. Dhe na ndihmon ta shohim Perëndinë ashtu siç është; të madh, të fuqishëm, të mrekullueshëm që meriton çdo lavdërim dhe si Ai që ne i shërbejmë duke iu shërbyer të tjerëve.

Nëse dëshirojmë që t'i duam njerëzit si Jezusi, duhet të ecim me versionin e Tij të madhështisë. Jezusi jetoi një jetë të përqendruar tek të tjerët që e çoi atë të ishte bujar, të shërbente, të falte, të mikpriste dhe t'iu tregonte të tjerëve për dashurinë e Perëndisë. Do i shqyrtojmë këto gjëra këtë javë.

Pra, çfarë po ndiqni në këtë jetë? Bota na fton të jemi “të mëdhenj” duke ndjekur synime personale që na çojnë drejt influencës dhe rehatisë. Por Jezusi na fton në një lloj tjetër madhështie, në atë që përqendrohet në ngritjen dhe kujdesjen e të tjerëve.

Dita 16

Mikpritja e Të Tjerëve

A je ndjerë ndonjëherë “si në shtëpi” në një vend që nuk ishte fare shtëpia jote? Ndoshta e ke atë ndjenjë në një kishë, kafene ose në shtëpinë e një miku. Ose mund të ndiheni si në shtëpi me një anëtar të familjes ose mik.

Të gjithë jemi “si në shtëpinë tonë” kur ndihemi të sigurt për të qenë vetvetja, të pa shqetësuar apo gjykuar se mos themi gjënë e gabuar sepse ndihemi të dashur dhe të pranuar ashtu siç jemi.

Ne të gjithë duam një vend ku të ndihemi “si në shtëpi”. Jezusi e dinte këtë gjë dhe kjo është arsyeja pse Ai i bëri njerëzit të ndiheshin si në shtëpinë e tyre kudo që shkoi. Ai e bëri këtë duke marrë kohë për t'i mirëpritur njerëzit në jetën e Tij, duke i dëgjuar, duke treguar ndjeshmëri dhe duke u dhënë atyre leje të jenë të sinqertë pa u gjykuar. Ne e quajmë këtë mikpritje.

Tek Luka 8, gjejmë një listë të njerëzve që e ndoqën Jezusin gjatë shërbesës së Tij. Këta ishin njerëzit që Jezusi i mirëpriti në jetën e Tij. Ata ishin njerëz me sfida dhe të metat e tyre, por mikpritja e Jezusit i ktheu ata njerëz në një lloj familje.



.....Të dymbëdhjetët ishin me të. Ishin edhe disa gra që Jezusi i kishte shëruar nga shpirtrat e këqij e nga sëmundjet: Maria, që quhej Magdalenë, prej së cilës ishin dëbuar shtatë djaj, Joana, gruaja e Kuzait, kujdestarit të pasurisë së Herodit, Suzana dhe shumë të tjera që kishin vënë pasuritë e veta në shërbim të Jezusit e të dishepujve. Luka 8:1-3

Ata ishin shumë të ndryshëm. Të dymbëdhjetët ishin nga shtresa të ndryshme të shoqërisë dhe vinin nga prejardhje të ndryshme. Ata do të kishin patur shumë arsye për të mos rënë dakord me njëri-tjetrin. Por Jezusi e mirëpriti secilin prej tyre ashtu siç ishin, për në familjen e Tij.

Pastaj ishte Maria Magdalena, një grua që Jezusi e çliroi nga shtypja frymërore. Pavarësisht sfondit të ashpër nga vinte, Jezusi e mirëpriti në rrethin e Tij të ngushtë.

Së fundi, le të flasim për Joanën. Ajo ishte gruaja e administratorit të shtëpisë së mbretit Herod. Mbreti Herod nuk ishte mik i Jezusit. Tek Mateu 14, Herodi urdhëroi ekzekutimin e kushëririt të Jezusit, Gjon Pagëzorit. Por Jezusi e mirëpriti Joanën që të ishte pjesë e shërbesës së Tij.

Mikpritja thyen barriera sociale dhe ndërton miqësi të pathyeshme. Mikpritja na fton të jemi më pak gjykues dhe më shumë kureshtarë. Ndhmon njerëzit të kuptojnë vlerën dhe potencialin e tyre të dhënë nga Perëndia. Ndërton ndjeshmëri dhe i kthen të huajt në të afërm.



Ndalo Për Pak Minuta Dhe Mendo:

Si e tregojmë ne mikpritjen? **Fillo duke menduar atë momentin kur dikush të bëri të ndiheshe i vlerësuar, i dëgjuar dhe i përfshirë. Si të ndryshoi ty mikpritja e tyre?** Më pas, mendo sesi mund ta krijosh ti të njëjtën ndjenjë dhe të ndikosh dikë duke u konsultuar me Perëndinë si të bëhesh sa më mikpritës.

Dita 17

Si Të Bëhesh Bujar?

Në muajt para fillimit të shërbesës së Jezusit, u përhapën fjalë për ardhjen e Shpëtimtarit të botës. Njerëzit kishin shumë ide sesi do të ishte Ai, kështu që shkuan te kushëriri i Jezusit për ta pyetur.

Shumë donin të dinin sesi mund të përgatiteshin për ardhjen e Shpëtimtarit dhe Gjon Pagëzori ua tha kështu:



... *“Kush ka dy tunika, le t’ia japë njëren atij që nuk ka. Ai që ka për të ngrënë, le të veprojë po kështu.”* Luka 3:11

Sipas Gjonit, **bujaria i bën vend Jezusit në zemrat tona.**

Bujari do të thotë të ndash atë që ke për të ndihmuar dikë tjetër. E shihni sa i thjeshtë është ky përkufizim? Nuk përfshin vetëm paratë tona por gjithçka që kemi, kohën, aftësitë, burimet.

Pra, si mund të bëhesh njeri bujar? Nuk është e komplikuar, por nuk është gjithmonë e lehtë. Ja disa mënyra sesi të bëhesh bujar.

1. Pyete veten: “Çfarë më duhet?”

Perëndia dëshiron që t’i shijojmë gjërat që kemi. Por nuk i zotërojmë ne ato. Ato janë të Perëndisë dhe Ai na kërkon që ta ndajmë atë që kemi me të tjerët. Pra, pyesni veten: “Çfarë më nevojitet vërtet?”

2. Pyete veten: “Çfarë kam për të ndarë?”

Ndoshta ke shumë kohë të lirë apo je i zoti në një zanat apo profesion. Ose ndoshta ke para që mund të bekosh të tjerët. Pavarësisht se çfarë është, nëse ke diçka, gjeje mundësinë dhe mënyrën për ta ndarë me dikë.

3. Pyete veten: “Çfarë nevojash ka komuniteti im?”

Njerëzit përreth teje kanë nevoja që mund t'i plotësosh. Ndoshta komshiu yt ka përjetuar një humbje dhe thjesht kur je bujar me fjalët dhe praninë tënde, kjo mund të sjellë ndryshim. Ose një shërbesë specifike në një lagje ka nevojë për vullnetarë ose donacione. Shikoj nevojat e komunitetit ku jeton dhe aty do të vijnë ide sesi të jesh bujar.

Ndjekësit e Jezusit i japin kishës së tyre rregullisht një pjesë nga ato që fitojnë, japin çdo javë. Pse? Sepse kisha po bën punën e Perëndisë në komunitet. Pra, kur i japim kishës, ne i ofrojmë asaj më shumë mundësi për të sjellë ndikim të përjetshëm tek jeta e dikujt.

Jezusi ishte bujar vetë dhe Ai na fton secilin të jetojmë si Ai. Ti i ke ato që të duhen për të qenë njeri bujar. Filloje duke identifikuar së pari atë që të nevojitet, pastaj çfarë ke për të ndarë me dikë dhe çfarë nevojash ka komuniteti ku ti je.

Dita 18

Dalloji Dhe Plotësoji Nevojat

Sot, le të shikojmë për një aftësi që na e tregon Jezusi në Bibël që ndonjëherë është e lehtë për t'u anashkaluar. Në shikim të parë duket si diçka e zakonshme. Por në fakt është një nga mënyrat më të rëndësishme sesi mund të duam si Jezusi.

Jezusi është i shkëlqyer në **dallimin e nevojave**.

Dhjetra histori në Bibël fillojnë me Jezusin duke shkuar diku dhe duke dalluar dikë në nevojë. Ndonjëherë nevoja e tyre ishte e dukshme dhe fizike. Herë të tjera ishte nën sipërfaqe ose brenda në shpirt. Sido që të ishte, Jezusi i dalloj nevojat e njerëzve rreth Tij.

Sa herë që Jezusi dallonte një nevojë, Ai e përdorte atë që kishte për ta përbushur nevojën. Ndonjëherë, Ai përdorte fjalët për ta plotësuar atë nevojë shpirtërore ose emocionale. Ai do të kërkonte ndihmën e Perëndisë për të plotësuar një nevojë fizike me anë të fuqisë së Frymës që jetonte në Të.

Si ndjekës të Jezusit, ne jemi thirrur të jetojmë një jetë të fokusuar tek ndihma ndaj të tjerëve. Një nga mënyrat më të mira për ta bërë këtë gjë është duke iu shërbyer të tjerëve. Ne u shërbejmë të tjerëve kur dallojmë nevojat e tyre dhe përdorim atë që kemi për ta plotësuar nevojën. Ashtu siç folëm dje, shpesh kjo gjë ngjan me rastin kur përdorim kohën, aftësitë dhe burimet tona për të ndihmuar të tjerët.

Ndonjëherë, nuk mund ta plotësojmë atë nevojë por kjo nuk do

të thotë se nuk mundemi të ndihmojmë. Në vend të kësaj, është një mundësi për t'i kërkuar ndihmë Perëndisë për ta plotësuar atë nevojë që është përtej mundësive tona.

Mos harroni, si ndjekës i Jezusit, ti ke Frymën e Shenjtë që jeton në ty.

Natën para ekzekutimit në kryq, Jezusi mbloodhi dishepujt e Tij dhe iu lau këmbët. Larja e këmbëve para ngrënies ishte një praktikë e zakonshme në atë kohë dhe, siç mund ta imagjiloni, ishte një detyrë për shërbëtorët më të ulët. Por Jezusi, Perëndia në trup njerëzor, zgjodhi t'i lante këmbët e ndjekësve të Tij që ishin njerëz jo të përsosur.

Ja çfarë tha Ai pasi ua lau këmbët:



“Unë, në fakt, ju kam dhënë shëmbullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju. Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Shërbëtori nuk është më i madh se padroni i tij, as i dërguari më i madh se ai që e ka dërguar. Po t'i dini këto gjëra, të lumur jeni ju nëse do t'i bëni.” Gjoni 13:15-17

Ndjekësit e Jezusit kërkojnë mënyra për t'u shërbyer të tjerëve. I dallojmë nevojat dhe me ndihmën e Perëndisë, i plotësojmë ato. Prandaj mbajini sytë hapur. Dalloje, a është dikush rreth e qark teje që ka nevojë për një fjalë inkurajimi, për lutje shërimi fizik, emocional ose nevojë për ndihmë në një gjë praktike? Ndërsa jeton një jetë me mendjen tek të tjerët, ke për të përjetuar një afërsi më të madhe me Perëndinë.

Dita 19

Të Falim Të Tjerët

Perëndia i jep rëndësi shumë të madhe faljes. Ai pëlqen të fal. Prandaj e gjen në të gjithë Biblën, Perëndia bujarisht ofron falje dhe mundësi të dyta për të gjithë njerëzit.

Si të krishterë, ne e dimë sesi është të jesh i falur. Të gjithë kemi bërë gabime dhe zgjedhje të gabuara. Por Perëndia na ofron falje nëpërmjet Jezusit – jo sepse e meritojmë atë, por sepse Perëndisë i pëlqen të falë.

Nuk është çudi që Jezusi fali shumë njerëz gjatë shërbesës së Tij. Ungjijtë na thonë se Ai ua fali mëkatet njerëzve. Në fund të misionit të Tij, Ai u rrah, u poshtërua dhe u gozhdua në kryq që të vdiste aty. Pavarësisht gjithë dhimbjes që përjetoj, disa nga fjalët e tij të fundit ishin:



...*"Atë, fali, se nuk dinë çfarë bëjnë."* ... Luka 23:34

Këtu mund të kuptojmë sesa shumë e do Jezusi faljen. Ai sheh potencialin që Perëndia i ka dhënë gjithësecilit dhe nuk ngutet të gjykojë.

Çfarë do të thotë kjo për ndjekësit e Jezusit? Ju ndoshta e keni kuptuar deri tani se: **Ndjekësit e Jezusit i falin të tjerët.**

Pjetri, një nga ndjekësit e Jezusit, e pyeti për faljen. Ai tha, sa herë duhet ta fal dikë që vazhdon të më mërzisë? A e gjen veten te kjo pyetje? Ke ndonjë që të mërzit shpesh apo të bezdis?

Te Mateu 18 gjejmë këtë:



Atëherë Pjetri erdhi te Jezui e i tha: “Zot, sa herë duhet ta fal vëllanë që mëkaton kundër meje? Deri në shtatë herë?”. Jezusi i tha: “Jo deri në shtatë herë, por deri në shtatëdhjetë herë shtatë.” Mateu 18:21-22

Tani, kjo s’do të thotë se Jezusi do që të numërojmë sa herë e falim dikë dhe më pas kur të shkojë shtatëdhjetë herë shtatë të ndalojmë. Jo, në vend të kësaj Ai po na inkurajon të praktikojmë faljen pa marrë parasysh asgjë.

Falja s’do të thotë të harrosh atë që të është thënë ose bërë dhe nuk do të thotë ta justifikosh atë që ka bërë dikush por, do të thotë të heqësh dorë nga nevoja për t’iu kthyer e rikthyer asaj gjëje. **Falja është shpallje që ti refuzon ta lejosh zemërimin, lëndimin ose tradhtinë të kontrollojë mendjen dhe veprimet e tua.**

Falja mund të përfshijë edhe limite. Ndonjëherë duhet të falim dhe t’i duam njerëzit nga larg dhe kjo për të mirën e shëndetit tënd dhe të të tjerëve.

Ne jemi njerëz të falur prandaj i falim të tjerët. Nuk është gjithmonë e lehtë dhe ndonjëherë mund të duket e pamundur por është një nga mënyrat më të mira sesi mund të jemi si Perëndia ynë që fal.

Lutu me fjalët e tua ose kështu:



Perëndi i dashur, faleminderit që më ke falur mua edhe kur nuk e meritoj. A do të më tregosh dikë që duhet ta fal dhe më jep forcë të fal si Ti? Në emrin e Jezusit, Amen.

Dita 20

T'u Tregojmë Të Tjerëve Për Jezusin

Në ditën e fundit të shërbesës të Jezusit, Ai u nda me dishepujt e Tij me keto fjalë:



... *"Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë, prandaj shkoni e mësojini të gjitha kombet dhe pagëzojini në emër të Atit, të Birit e të Shpirtit të shenjtë. Mësojini të zbatojnë gjithë sa ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju të gjitha ditët, deri në mbarim të botës".* Mateu 28:18-20

Le ta shikojmë këtë pasazh së bashku.

"Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë"

Jezusi është sundimtari i qiellit dhe i tokës. Ai është Mbreti dhe ne jetojmë në Mbretërinë e Tij. Mbretëria e Jezusit nuk ngjan me asnjë komb tjetër në tokë. Kjo ndodh sepse është e mbushur me njerëz që zgjedhin të jetojnë dhe të duan si Jezusi dhe këtë e tregojnë përmes shërbesës, bujarisë, mikpritjes dhe faljes.

"Prandaj shkoni e mësojini të gjitha kombet dhe pagëzojini në emër të Atit, të Birit e të Shpirtit të shenjtë. Mësojini të zbatojnë gjithë sa ju kam urdhëruar."

Jo të gjithë e kanë përjetuar hirin, faljen dhe pranimin e Jezusit. Jezusi dëshiron ta ndryshojë këtë dhe Ai kërkon ndihmën tonë. Kështu që Ai na kërkon të shkojmë në lagjet tona, te puna jonë dhe në gjithë botën, duke iu dhënë dashuri njerëzve siç bënte

Jezusi dhe duke iu treguar gëzimin, pasionin dhe qëllimin e një jete që është e përkushtuar plotësisht Atij.

Nga ana praktike kjo mund të ngjajë: I fton ata në kishë, ndan dëshminë tënde, atë që Perëndia ka bërë në jetën tënde... Ka shumë mënyra sesi Perëndia mund të përdorë ty për të ndarë dhe treguar dashurinë e Tij ndaj të tjerëve rreth e qark teje.

“Dhe ja, unë jam me ju të gjitha ditët, deri në mbarim të botës.”

Ndërsa shkojmë në botë duke u treguar njerëzve për Jezusin, ne nuk jemi vetëm. Jezusi është me ne në çdo hap të rrugës përmes Frymës së Shenjtë. Fryma e Shenjtë na inkurajon dhe na jep forcë ndërsa e ndjekim thirrjen tonë.

Si i bindemi urdhërimit të Jezusit për të ndarë mesazhin e Tij me botën? Të krishterët shpesh e quajnë qasjen tonë për të ndarë për Jezusin si “mision”. Ne marrim pjesë në misione në nivel lokal duke u përpjekur ta njohim të afërmin tonë dhe duke kërkuar mënyra për të përmbushur nevojat e njerëzve në vendin tonë. Ndërsa njohim të tjerët, ne ndajmë historitë tona dhe mënyrat se si Jezusi është duke e ndryshuar jetën tonë.

Ndërsa jetoni dhe shërbeni në lagjen ose qytetin tuaj, kërkon mënyra për të mbështetur edhe misionet globale. Ka misionarë me kohë të plotë kudo në botë. Shumë fokusohen në nevojat specifike, si përkthimi i Biblës, edukimi, ndihma në katastrofa dhe luftëra kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Të gjithë mund t'i mbështesim këto misione përmes lutjes. Madje edhe mund të zgjidhni të mbështesni punën e tyre duke dhënë ose duke qënë vullnetarë. Pyet te kisha jote si bëhet joko gjë, a mbështet ajo një mision jashtë Shqipërisë?

Dita 21

Çfarë Ndodh Më Pas?

POTHUAJSE e mbarove së lexuari këtë libër, por historia jote sapo ka filluar. Ne krenohemi me ty që e nise këtë udhëtim. Sot, duam të shikojmë disa fjalë nga një ndjekës i hershëm i Jezusit i cili quhej Pal.



... Jam i sigurt se ai që nisi një vepër të mirë mes jush, do ta përfundojë deri në ditën kur do të vijë Krishti Jezus..
Filipianëve 1:6

Pali ua shkroi këto fjalë një grupi ndjekësish të Jezusit dy mijë vjet më parë. I gjithë kapitulli është plot me inkurajime për njerëzit që bëjnë çmos për ta ndjekur Jezusin çdo ditë. Ata nuk ishin të përsosur, por po bënin progres, siç jemi edhe ne.

Ne s'e dimë ekzakt se ku ishte ti kur të gjeti Jezusi, dhe ti zgjodhe ta ndjekësh Atë. Dhe s'i dimë sfidat që të janë dashur të kapërcesh këto kohë. Por jemi të sigurtë se Perëndia që ka filluar një punë të mirë në ty, Ai do e vazhdojë punën e Tij për pjesën tjetër të jetës tënde.

Lutja jonë për ty është e njëjta lutje që Pali ndau me disa nga ndjekësit e parë të Jezusit në qytetin e lashtë të Filipisë:



Unë lutem që dashuria juaj të rritet gjithnjë e më shumë e të pasurohet me dije e me aftësi për të kuptuar. Filipianëve 1:9

Ti the Po! Vazhdo t'i thuash Po Jezusit çdo ditë. Kërko rritje, jo përsosmëri. Zoti është dashuri, kështu që nuk do të të

braktisë kur jeta të bëhet e vështirë ose kur të bësh një gabim. Nuk do të jetë gjithmonë e lehtë, por ndërsa ecën përpara, do të dëshmosh se Perëndia punon rreth teje dhe në ty ndërsa jeton të përditshmen dhe ndërsa i do të tjerët si Jezusi.

Pra, çfarë ndodh më pas?

Udhëtimi yt për të ndjekur Jezusin është unik:

Mund të zgjedhësh të jesh pjesë e një grupi të vogël dhe të krijosh miqësi të reja aty.

Mund të zgjedhësh të informohesh më shumë për kishën tënde.

Mund të zgjedhësh t'i përdorësh dhuntitë e tua për të sjellë ndryshim përmes shërbimit.

Ose mund të zgjedhësh diçka krejtësisht të ndryshme!

Këtë fundjavë kur të shkosh në kishë, bëja të ditur pastorit që e mbarove librin. Ai do që të përgëzojë dhe do të ndihmojë për të gjetur hapin e rradhës ndërsa po ndjek Jezusin.

Ndërkohë hidhi një sy faqes tjetër për disa mundësi të tjera për t'u rritur në besimin.



Hapat e Rradhës

Urime për përfundimin e librit! Shpresojmë që të ka dhënë njëfarë qartësie, besimi dhe drejtimi si ndjekës i Jezusit.

Po tani, çfarë?

Gjëja më e mirë që mund të bësh tani është të vazhdosh të marrësh hapa të përditshëm, për të cilët ke lexuar në këtë libër. Nuk ka një rrugë të prerë me thikë për ta ndjekur Jezusin, por ne kemi vënë re disa hapa të përbashkët.

Shpresojmë që t'i lexosh këto hapa të zakonshëm dhe të fasësh me një pastor për të ndërmarrë me pas hapin që është me i miri për ty, që mund të jetë:

Të pagëzohesh

Të bëhesh pjesë e një grupi të vogël

Të ndash vendimin që more për ta ndjekur Jezusin me një mik, anëtar të familjes, koleg...

Të fillosh të shërbesh

Të kërkosht këshillim

Të ftosh dikë në kishë

Të bësh diçka për kishën ose komunitetin tënd

Ose çfarëdo hapi tjetër që Fryma e Perëndisë po të drejton.

Edhe një herë, urime për përfundimin e këtij libri! Është i yti, ose mbaje ose jepja dikujt që mund t'i duket ndihmë siç ishte për ty.

Shënime

Shënime

Shënime

Shënime

